



Datë: 25.03.2026

A.nr.1829/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Koleji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga:** Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1829/2025, të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi B.F, kundër Vendimit me numër protokollit 02-030/07-10393/25, të datës 09.10.2025, të Kryetarit të Komunës së Shtërpçës, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1829/2025, e datës 22.10.2025, e parashtruar nga ankuesi B.F.
- II. Obligohet** Kryetari i Komunës së Shtërpçës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të eliminoj shkeljet e konstatuar si në arsyetimin e vendimi në atë mënyrë që të shfuqizoj Vendimin me numër protokollit 02-030/07-10393/25, të datës 09.10.2025 dhe së të nxjerrë akt të ri lidhur më emërimin e Menaxherit të Kontratës për Rregullimin e rrugës “Imri Halili” në fshatin Firajë, emërim ky në pajtim të plotë më legjislacionin për prokurim publik.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra, në zbatim të këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Ankuesi B.F (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 22.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 02-030/07-10393/25, të datës 09.10.2025, të Kryetarit të Komunës së Shtërpçës, përmes të cilit akt ankuesi është emëruar menaxher i Kontratës për Rregullimin e rrugës “Imri Halili” në fshatin Firajë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Shtërpçës, ndërsa, kjo e fundit ka dërguar përgjigjen në ankesë.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova:*** Ankesën me numër protokollit 6930/2025 të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; ID e ankuesit; Vendimin me numër protokollit 02-030/07-10393/25 të datës 09.10.2025 të Kryetarit të Komunës së Shtërpçës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.10.2025 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 04.11.2025; Akt Emërimit me numër protokollit 02-030-01-7977/23 të datës 05.07.2023; Diplomën me Nr. 6861, datë 02.03.2020, të ankuesit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

### *I. Vlerësimi i gjendjes së fakteve*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se:

-Ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër protokollit 02-030-01-7977/23, të datës 05.07.2023, është i punësuar në pozitën Shef i Zyrës për Komunitete në Komunën e Shtërpçës.

-Kryetari i Komunës së Shtërpçës më Vendimin me numër protokollit 02-030/07-10393/25, të datës 09.10.2025, ka emëruar ankuesin Menaxher i Kontratës për Rregullimin e rrugës “Imri Halili” në fshatin Firajë.

### *II. Pretendimet ankimore*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se vendimi i kontestuar nuk është i bazuar në dispozitat ligjore respektivisht është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik sepse ankuesi nuk ka përvojë profesionale e as trajnime në fushën e projekteve e menaxhimit të kontratave, kështu që emërimi i një juristit në këtë pozitë nuk është në frymën e parimeve ligjore. Kërkon të anulohet vendimi i kontestuar.

### *III. Vlerësimi i Kolegjit*

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore ju referua dispozitave ligjore në fuqi që rregulloje çështje lidhur me menaxhimin e kontratave të prokurimit publik, më theks të veçantë:

1. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, më konkret nenit 81 paragrafi 2 dhe 3, ku përcaktohet se: 2. *Plani i menaxhimit duhet të jetë i rënë dakord midis palëve të kontratës dhe të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës. KRPP-ja është e autorizuar të nxjerrë një formular standard për planin e menaxhimit të kontratës dhe rregullat e mëtejme që detajojnë dhe plotësojnë temat e përmendura më sipër në lidhje me menaxhimin e kontratave.* 3. *Plani i menaxhimit të kontratave duhet të paktën të përfshijë: (i) emrin e zyrtarit/zyrtarëve të autoritetit kontraktues përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe ku është e aplikueshme, rezidentin e kualifikuar për mbikëqyrje apo inxhinierin /inxhinierët e projektit; (ii) numri dhe kategoritë e personelit ndihmës në dispozicion të zyrtarit për qëllime të menaxhimit të kontratave, duke përfshirë ekspertë teknik të jashtëm të rekrutuar; (iii) një afat kohor ose një plan projekt gantogram (ganat charts), diagrame për aktivitetet e menaxhimit të kontratave që përfshijnë kohëzgjatjen e kontratës. KRPP-ja monitoron menaxhimin e kontratës.*

2.. Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70, pikat 70.18, 70.19, dhe 70.20, ku përcaktohet: 70.18 *ZKA do ta emërojë një person nga Njësia Kërkuese, me shkathtësi dhe përvojë të duhur, si Menaxher të Kontratës dhe një person nga Njësia Kërkuese si Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës.* 70.19 *Ku është e përshtatshme, ZKA mund të emërojë një person nga një departament tjetër si Menaxher të Kontratës. apo Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës.* 70.20 *Për kontrata për punë dhe kontrata të projektimit emërohet Ekipi për Menaxhimin e Kontratës, i cili ka përgjegjësitë e njëjta sikurse Menaxheri i Kontratës, të përcaktuara me nenin 70.23 të kësaj rregulloreje. Ekipi për Menaxhimin e Kontratës përbëhet nga profesionist sipas fushëveprimit të kontratës, ku secilit anëtar të ekipit i përcaktohet përgjegjësia për pjesë përkatëse të fushëveprimit të kontratës. Njëri nga anëtarët e ekipit emërohet si udhëheqës i ekipit dhe i njëjti po ashtu do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës përmes platformës elektronike e-prokurimi.*

Rrjedhimisht, më qëllim të vendosjes së drejtë dhe meritore lidhur me çështjen në procedurë, Këshilli më datë 19.03.2026, i është drejtuar Komisionit Rregullator i Prokurimit Publik (KRRPP) si institucion përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë( neni 87.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës), më krese për sqarim ligjor lidhur me çështjen e emërimit të menaxherit dhe ekipit për menaxhim të kontratave të prokurimit publik, ndërsa, Këshilli më datës 24.03.2026, ka pranuar sqarimin ligjor nga KRRPP-ja lidhur me kërkesën e datës 19.03.2026, me përmbajtjen citojmë:... *Emërimi i Menaxherit të Kontratës, mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës si dhe ekipit për menaxhimin e kontratës rregullohet me nenin 70 të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik. Ndërsa, lidhur me pyetjen tuaj konkrete, neni 70.18,70.19 dhe 70.20 i Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik përcaktojnë: 70.18 ZKA do të emërojë një person nga Njësia Kërkuese me shkathtësi dhe përvojë të duhur, si Menaxher të Kontratës dhe një person nga Njësia Kërkuese si Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë I menaxherit të kontratës.70.19 Ku është e përshtatshme, ZKA mund të emërojë një person nga një departament tjetër si Menaxherit të Kontratës apo Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës.70.20 Për kontrata për punë dhe kontrata të projektimit emërohet Ekipi për Menaxhimin e Kontratës, i cili ka*

*përgjegjësitë e njëjta sikurse Menaxheri i Kontratës, të përcaktuara në nenin 70.23 të kësaj rregulloreje. Ekipi për Menaxhimin e Kontratës përbëhet nga profesionist sipas fushëveprimit të kontratës, ku secilit anëtar të ekipit i përcaktohet përgjegjësia për pjesë përkatëse të fushëveprimit të kontratës. Njëri nga anëtarët e ekipit emërohet si udhëheqës i ekipit dhe I njëjti po ashtu do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës përmes platformës elektronike e-prokurimit. **Sipas diapozitivave të lartpërmendura si Menaxher i Kontratës ashtu edhe ekipi për Menaxhimin e Kontratës duhet të përbëhen nga persona të kualifikuar, me shkathtësi, përvojë dhe profesionalizëm të përshtatshme , në përputhje me natyrën dhe fushëveprimin e kontratës.***

Referuar kuadrit ligjor si me sipër dhe marrë për bazë si fakt relevante sqarimin e KRRPP-së të datës 24.03.2026, Kolegji erdhi në përfundimin se Ekipi për menaxhimin e kontratës duhet të përbëhet nga zyrtarë që kanë kualifikime dhe përvojë lidhur me fushën e menaxhimit të kontratës, andaj, mbi bazën e këtij konstatim dhe duke qenë së në rastin ankimor kemi të bëjmë me Menaxhim të Kontratës për Rregullimin e rrugës “Imri Halili” në fshatin Firajë, ku kërkohet kualifikimeve dhe përvojë në fushën e ndërtimit dhe infrastrukturës rrugore, atëherë, Menaxher i Kontratës ashtu edhe ekipi për Menaxhimin e Kontratës duhet të përbëhen nga persona të kualifikuar, me shkathtësi, përvojë dhe profesionalizëm të përshtatshme, në përputhje me natyrën dhe fushëveprimin e kontratës, ndërsa, ankuesi në cilësi të menaxherit të kontratës është më profesion të juristit, ushtron pozitën e udhëheqësit të zyrës për komunitete dhe për me tepër organi i punësimit më asnjë provë nuk ka arritur të argumentoj faktin nëse ankuesi posedon përvojë punë të ngjashme përkitazi me fushën e kontratës. Rrjedhimisht, në ndërlidhje më këtë, edhe vet Njësia e Personelit të Komunës së Shtërpcës përmes përgjigjes në ankesë të datës 04.11.2025 deklaroi se: .. *pozita e menaxherit të punimeve të infrastrukturës për nga natyra e tij dhe në përshkrimin e punës, kërkon kualifikime teknik, njohuri profesionale dhe përvojë në fushën e projekteve të ndërtimit dhe infrastrukturës, në rastin konkret personi i emëruar është jurist gjë që është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik, duke kërkuar që pranohet ankesa si e bazuar dhe të urdhërohet anulimi i Vendimit me numër protokoli 02-030/07-10393/25.*

Andaj, nisur nga rrethanat dhe të gjeturat si më lartë, Kolegji konstaton së pretendimet ankimore janë të bazuar dhe së ankuesi me të drejtë refuzon emërimin e tij si Menaxher i Kontratës për Rregullimin e rrugës “Imri Halili” në fshatin Firajë, emërim ky sipas Vendimit me numër protokoli 02-030/07-10393/25 të datës 09.10.2025 të Kryetarit të Komunës së Shtërpcës, sepse, i njëjti nuk ka përvojë dhe shkathtësi lidhur me fushën e kontratës në fjalë, kështu që, duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*A.nr.1829/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

\_\_\_\_\_  
*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

\_\_\_\_\_  
*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit B.F;
- Komunës së Shtërpcës: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK-së.